



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq./Br.str./No. pë 48

Data/Date/Datë 30/03/2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2023, merr këtë:

V E N D I M

- Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/280/23 i datës 10.03.2023 dhe meret vendimi për riparcelizimin e parcelave kadastrale në Zonën Kadastrale Rahovec, sipas certifikatës së pronësisë, si në vijim:
 - Nr. 71510057-01313-1 në sipërfaqe të përgjithshme prej 910m² në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY. DREJTORIA PËR KULTURË;
 - Nr. 71510057-01313-2 në sipërfaqe të përgjithshme prej 200m² në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY. DREJTORIA PËR KULTURË;
 - Nr. 71510057-01313-3 në sipërfaqe të përgjithshme prej 828m² në bashkë posedim të Hajrullah (Bahtjar) Dula, Tasim (Bahjtjar) Dula dhe Ysnije (Sefer) Dula;
 - Nr. 71510057-01313-4 në sipërfaqe të përgjithshme prej 71m² në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY. DREJTORIA PËR KULTURË; dhe
 - Nr. 71510057-01313-5 në sipërfaqe të përgjithshme prej 271m² në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY. DREJTORIA PËR KULTURË.
- Qëllimi i riparcelizimit të parcelave kadastrale të cekura në pikën 1 të këtij vendimi është realizimi i projektit për ndërtimin e Sheshit Qendror të Qytetit.
- Obligohet drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë riparcelizimin e parcelave dhe rregullimin e dokumentacionit teknik në librin kadastral.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.48/23
Me datë:30.03.2023

